



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 49/19
Prishtinë, më 28.03.2019, në orën 18:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhjen morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Blerim Kuçi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontic dhe Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza – Ministër i Financave

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari i Komisionit).

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit.

Kryetari i Komisionit: Ju keni projektligjin përpara. Propozimi është të heqet lotaria e lojërave të fatit në nenin 1 dhe 2. Pra nenin 1 dhe 2 të riformulohen si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Ligj ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Shfuqizimi

Me këtë Ligj shfuqizohet Ligji nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij.

Naser Osmani: Theksoi se tek neni dy, ndoshta do të ishte mirë të thuhej që shfuqizohen të gjitha licencat që janë në fuqi për lojërat e fatit, pasi që shfuqizimi i ligjit dhe akteve nënligjore nënkupton edhe shfuqizim të licencave.

Blerim Kuçi: Ajo çfarë propozoi Naseri, mendojë se janë çështje e qeverisë dhe ne nuk mund të ndërhyjmë me ligj. Qeveria ndërmerret me punën e licencave dhe ankesave. Çështja e ligjit është vetëm shfuqizimi i ligjit dhe akteve nënligjore dhe jo vendimeve tjera të Qeverisë.

Bedri Hamza: Kur nuk ka bazë legale atëherë nuk mundemi me fol për veprimtari të caktuar apo për licenca. Prandaj, unë mendoj që ne duhet të specifikojmë me ligj që ato që kanë ushtruar veprimtarinë e lojërave të fatit, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë aktivitetin.

Blerim Kuçi: Tek qëllimi ne mund të themi, se me këtë ligj mund të themi ndalohen dhe mbyllen lojëra e fatit.

Kryetari i Komisionit: Propozimi është që nenin 1 dhe 2 të riformulohen si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Ligj ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit.

Neni 2

Shfuqizimi

Me këtë Ligj shfuqizohet Ligji nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij.

Znj. Arbërie duheni me tërheq amendamentin që keni propozuar se tani nuk ka kuptim.

Mërgim Lushtaku: Pajtohem me gjitha ato që u thanë, por kam një shqetësim. E ngriti në seancë znj. Mimoza Kusari-Lila qështje për lojërat ilegale që mund të ushtrohen. A duhet të rregulluar me një ligj tjetër apo duhet theksuar se me këtë ligj ndalohen të gjitha lojërat e fatit dhe vepron kodi penal apo ligji kompetent.

Arbërie Nagavci: Duhet shikuar se a quhen këto veprimtari lojëra të fatit apo kanë ndonjë status tjetër të biznesit. Duhet shikuar terminologjia. Ligji nuk vepron retroaktiv, mirëpo me miratimin e këtij ligji duhet ndërpritet licenca ndaj atyre që ushtrojnë veprimtari të lojërave të fatit.

Naser Osmani: ajo që theksoi Blerimi, me nenin 2, me miratimin e këtij ligji ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit. Unë propozoj që në nenin 2, të shtojmë edhe tekstin “në tërë territorin e Republikës së Kosovës”. Pra, formulimi të jetë: “Me këtë Ligj ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.”

Ali Lajçi: Duhet të theksuar se themelohet një ligj i ri.

Kryetari i Komisionit: Propozimi është që nenin 1 dhe 2 të riformulohen si vijon:

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Ligj ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 2

Shfuqizimi

Me këtë Ligj shfuqizohet Ligji nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij.

Ne mund t’ia dërgojmë një letër Qeverisë që të nis procedurat për hartimin e Projektligjit për Lotarinë e Kosovës.

Mërgim Lushtaku: Jam kundër monopolit. Nuk kemi nevojë të propozojmë një ligj tjetër për lojërat e fatit.

Kryetari i Komisionit, në bazë të propozimit, konstatoi se Komisionit njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.06/L-155, për ndalimin e lojërave të fatit, me amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 1, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Ligj ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 2

Neni 2, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 2

Shfuqizimi

Me këtë Ligj shfuqizohet Ligji nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij.

Kryetari i Komisionit: Ne procedojmë raportin në komisionet tjera të përhershme. Në rast se komisionet tjera të përhershme nuk bëjnë vërejtje, ne e dërgojmë në seancë, raportin me dy amendamentet që miratuam.

Mbledhja përfundoi në orën 18:10.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari i Komisionit,

Lumir Abdixhiku